



PK. G.H.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Pošta Kosova D.D.
Nr./No./Br. 01-1759/20
Data/Date/Datum 02-10-2020
PRISHTINË-PRISTINA-PRISTINA

**Ndërmarrja Publike Qendrore
Posta e Kosovës Sh.A.**

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Përkohshëm i Postës së Kosovës, në mbledhjen nr. 12/2020 të datës 28/9/2020, aprovoi këtë:

**RREGULLORE PËR FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONIT FINANCIAR JO BANKAR
POSTA E KOSOVËS SH.A.**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i procedurave për funksionimin e Komiteti Mbikëqyrës të IFJB-së dhe komiteteve tjera të IFJB-së, kriteret themelore të përzgjedhjes, procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Komiteti Mbikëqyrës dhe anëtarëve të komiteteve, mënyra dhe lartësia e kompensimit të anëtarëve të Komiteti Mbikëqyrës dhe komiteteve tjera të IFJB-së, përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësi të komiteteve dhe Kryeshefit Ekzekutiv/Menaxherit të Përgjithshëm të IFJB-së.

Qëllim tjetër i kësaj Rregulloreje është që organet udhëheqëse të IFJB-së të jenë në harmoni të plotë me kërkesat rregullatorë të BQK-së, dispozitat ligjore dhe rregulloret e BQK-së në fushën e veprimtarisë së IFJB-së.

**Neni 2
Organet qeverisëse të IFJB-PK Sh.A.**

1. Organet e qeverisjes së IFJB-së janë emëruar me rastin e licencimit të IFJB-së, këto organe duhet të veprojnë në përputhje me parimet e pranuar të qeverisjes së mirë për të siguruar, që biznesi i institucionit realizohet në mënyrë të sigurtë dhe të shëndoshë. Qeverisja e IFJB-së duhet të jetë në pajtueshmëri me Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, rregulloret e BQK-së si dhe kërkesat e BQK-së.
2. IFJB-PK Sh.A. do të qeveriset sikurse është përcaktuar me nenin 97 paragrafi 1 të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare, nga Komiteti Mbikëqyrës që është përcaktuar nga BQK, anëtarët e Komiteti Mbikëqyrës do të emërohen nga themeluesit, aksionarët

ose pronarët të cilët do të jenë numër tek prej jo më pak se tre 3, e jo më shumë se 5 anëtarë, nga të cilët shumica duhet të jenë të pavarur dhe jo-ekzekutiv nga struktura organizative e IFJB-së së Postës së Kosovës.

3. IFJB-PK Sh.A., përveç Komiteti Mbikëqyrës, ka edhe komitetin për menaxhimin e riskut të përcaktuar nga BQK me rastin e licencimit bazuar në paragrafin 3 të nenit 98. të Ligjit nr. 04./L-093 për Bankat, Institucionet Mikro-financiare dhe Institucionet Financiare Jo Bankare, IFJB-ja mund të ketë edhe komitete tjera sipas nevojës.
4. Kryeshefi Ekzekutiv/Menaxheri i IFJB-së, përveç se është anëtar i Komiteti Mbikëqyrës i IFJB-së, menaxhon me gjithë Departamentin e IFJB-së brenda Postës së Kosovës.

Neni 3

Kriteret dhe Procedura e Përzgjedhjes së anëtarëve të Komiteti Mbikëqyrës dhe Komiteteve tjera të IFJB-së

1. Të gjithë anëtarët e Komiteti Mbikëqyrës dhe komiteteve tjera të IFJB-së duhet të jenë të përshtatshëm me reputacion të mirë, duke i plotësuar kriteret e caktuara nga BQK-ja lidhur me kualifikimet, përvojën dhe integritetin e tyre.
2. Për tu përzgjedhur anëtar i Komiteti Mbikëqyrës dhe komiteteve tjera kërkohen këto kritere.
 - 2.1. të kenë diplomë universitare në ekonomi, jurisprudencë ose fushë tjetër relevante;
 - 2.2. të kenë përvojë profesionale jo më pak se 3 (tre) vjet në sektorin bankar dhe/ose financiar ose në ndonjë fushë tjetër të konsideruar të përshtatshme nga BQK;
 - 2.3. të kenë reputacion të lartë etik dhe profesional;
 - 2.4. nuk është dënuar nga një gjykatë penale për vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burgim prej një viti a më shumë, për te cilat nuk është përcaktuar opsioni i gjobës.Këto kritere vlejné vetëm për rekrutim nga ana e Postës së Kosovës ndërsa BQK për aprovimin e anëtarëve vendos në bazë te kriterëve të përcaktuar vet.
3. PK Sh.A. duhet t'i shfrytëzojë resurset e brendshme për anëtarë të Komiteti Mbikëqyrës dhe komiteteve tjera, duke shpallur konkurs të brendshëm sipas rregulloreve ne fuqi për rekrutimin e stafit të brendshëm, Nëse edhe pas shpalljes së konkursit të brendshëm nuk gjenden kandidatë që i plotësojnë kriteret, atëherë Kryeshefi Ekzekutiv i Postës së Kosovës, në mungesë të resurseve të brendshme, mund të angazhojë anëtarë edhe nga jashtë, duke respektuar procedurat e konkursit publik.
4. Vendimin dhe shpalljen për përzgjedhje të anëtarëve të Komiteti Mbikqyres dhe komiteteve tjera e merr Bordi i Drejtorëve të PK-së i cili autorizon Kryeshefin Ekzekutiv të Postës së Kosovës, për krijimin e komisionit për përzgjedhjen e anëtarëve të cilin komisione e kryeson vet.

5. Komisioni për përzgjedhjen e anëtareve duhet ti propozoj Bordit të drejtorëve të PK-së së paku 10 anëtarë të cilët i plotësojnë kushtet sipas paragrafit 2 të nenit 3 të kësaj rregullore, nga 10 anëtarët e propozuar, Bordi i drejtorëve i PK-së do i propozon emrat e anëtareve Kryeshefit Ekzekutiv të PK-së i cilët në koordinim me Kryeshefin Ekzekutiv/Menaxherin e IFJB-së i dërgojnë në BQK për aprovim ndërsa anëtarët tjerë mbesin në listën e pritjes në rast të refuzimit nga ana e BQK-se të ndonjë anëtari.
6. Afati i mandatit të anëtarëve të Komiteti Mbikëqyrës dhe komiteteve tjera të IFJB-së rrjedh nga dita e miratimit nga BQK-ja dhe është 5 vjeçar, me mundësi vazhdimi me vendim të Bordit të drejtorëve të PK-së.
7. Mandati i anëtarëve të Komiteti Mbikëqyrës dhe Komiteteve tjera mund të ndërpritet apo të shkarkohen, nëse të njëjtit kanë dështuar t'i kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë ligjore për çka janë përzgjedhur, kanë shkelur rregullat e BQK-së me kërkesë të BQK-së, nëse janë dënuar me aktgjykim të formës së prerë për ndonjë vepër penale apo edhe kanë bërë shkelje të rëndë të Kodit të Mirësjelljes dhe Procedurave Disiplinore.
8. Komiteti Mbikëqyrës dhe komitetet tjera të IFJB-së komunikojnë me BQK-në, Kryeshefit Ekzekutiv të Postës së Kosovës dhe Bordit të Drejtorëve të Postës së Kosovës si pronar/aksionar i IFJB-së nëpërmjet Kryeshefit ekzekutiv apo Menaxherit të IFJB-së, në raste të veçanta raportojnë edhe direkt tek Bordi i drejtorëve të PK-së dhe kryeshefi ekzekutiv.

Neni 4

Përgjegjësitë e Komiteti Mbikëqyrës të IFJB-së së Postës së Kosovës

Komiteti Mbikëqyrës i IFJB-së, gjatë kryerjes së aktiviteteve të tij, do të respektojë në përpikëri dispozitat ligjore në fuqi, rregulloret e BQK-së, Statutin e IFJB-së dhe aktet nënligjore, si dhe vendimet e Bordit të Drejtorëve të PK Sh.A., të cilat janë në pajtueshmëri me ligjin.

Neni 5

Përgjegjësitë e komiteteve tjera të IFJB-së

Komitetet IFJB-së janë përgjegjëse për të ndihmuar Komitetin Mbikëqyrës të IFJB-së. Detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara me ligjin në fuqi dhe rregulloret e BQK-së, por duhet të veprojnë edhe me kërkesat e Komiteti Mbikëqyrës të IFJB-së.

Komitetet e IFJB-së, gjatë kryerjes së punës së vet, do të respektojnë Statutin e IFJB-së dhe aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe do të zbatojnë vendimet e Bordit të Drejtorëve të PK Sh.A. dhe Komiteti Mbikëqyrës të IFJB-së, të cilat janë në pajtueshmëri me ligjin.

Neni 6

Kompensimi i anëtarëve të komiteteve të IFJB-së

1. Kompensimi i anëtarëve të Komiteti Mbikëqyrës dhe komiteteve tjera caktohet me vendimin e Bordit të drejtorëve të PK-së .
2. Kompensimi ka për qëllim themelor bartjen proporcionale të ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësisë ligjore që bartë funksioni i anëtarëve të Komiteti Mbikëqyrës dhe komiteteve tjera, për çka do të caktohet një lartësi për të mbajtur dhe tërhequr kandidatët me përvojë profesionale dhe që kontribuojnë në mbajtjen e nivelit të performancës së IFJB-së.

Neni 7

Kryeshefi Ekzekutiv/ Menaxheri i Përgjithshëm i IFJB-së

1. Kryeshefi Ekzekutiv/ Menaxheri i IFJB-së kryen detyrat dhe përgjegjësitë sipas ligjit në fuqi dhe konform përgjegjësive dhe përkrahimit të detyrave të punës sipas Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës për Punonjësit e Postës së Kosovës.
2. Sipas nenit 99 të Ligjit nr. 04./L-093, aktivitetet e përditshme të institucionit mikro-financiar, ose institucionit jo-bankar financiar janë përgjegjësi e Kryeshefit Ekzekutiv/ Menaxherit të IFJB-së, të caktuar nga Komiteti Mbikëqyrës, të cilit ai do t'i raportojë.
3. Kryeshefi Ekzekutiv/ Menaxheri i IFJB raporton për çështje të IFJB-së BQK-së, Kryeshefit Ekzekutiv të PK SH.A, dhe komiteti Mbikëqyrës të IFJB-së, ku është edhe vet anëtar dhe komitetet tjera të IFJB-së.
4. Para se të emërohet, ky person duhet paraprakisht t'i paraqitet BQK-së për rishikim dhe miratim.
5. Përzgjedhja e Kryeshefit Ekzekutiv/ Menaxherit të Përgjithshëm të IFJB-së bëhet sipas procedurave të konkursit konform Rregullores për Rregullimin e Marrëdhënies së Punës të PK SH.A.

Neni 8

Mbledhjet e Komiteti Mbikëqyrës dhe komiteteve tjera të IFJB-së

1. Mbledhjet e Komiteti Mbikëqyrës dhe komiteteve tjera thirren nga Kryesuesi i Komiteti Mbikëqyrës dhe Komiteteve tjera apo nga 2 anëtar përmes personit të autorizuar të IFJB-së i cili mban dhe përpilon Procesverbalet e takimeve.

2. Rendi i ditës i dërgohet anëtarëve të Komitetit Mbikëqyrës dhe komiteteve tjera së paku tri (3) ditë para mbledhjes, kurse materialet dërgohen me faks apo e-mail apo me çfarëdo mënyre tjetër, të cilat sigurojnë pranimin me kohë.
3. Përveç mbledhjeve të rregullta, Komitetet mund të mbajë edhe mbledhje të jashtëzakonshme për çështje të rëndësishme dhe urgjente, ku kërkohet zgjidhje nga Komiteti, si dhe për çështje që nuk mund të presin deri në takimin e planifikuar të radhës, njoftimi për mbledhje të jashtëzakonshme duhet të përcillet së paku një ditë para mbledhjes.
4. Mbledhjet mund të thirren edhe me kërkesën zyrtare të arsyetuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i Postës apo dhe Bordi i Drejtorëve të Postës për çështje me rëndësi të madhe për IFJB-në.
5. Përveç Kryeshefit Ekzekutiv/ Menaxherit të Përgjithshëm të IFJB-së, në një mbledhje të Komitetit mund të ftohen të marrin pjesë edhe zyrtarë tjerë të IFJB-së, në rast se kjo pjesëmarrje siguron kuptim ose shpjegim më të mirë të një raporti, ngjarje apo të rrethanave.
6. Kryesuesi mund të autorizojë një nga anëtarët e Komitetit që ta përfaqësojë (zëvendësojë), ose të kryejë detyra specifike gjatë mungesës së tij, ose nëse është e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tij.
7. Komiteti Mbikëqyrës dhe Komitet tjera do të takohen së paku tri herë brenda vitit.

Neni 9 **Veprimet gjatë mbledhjes**

1. Mbledhjet do të fillojnë me një përcaktim të pranisë së kuorumit për mbledhje nga ana e Kryesuesit dhe rishikim të rendit të ditës së mbledhjes, si dhe procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Kryesuesi do të sigurojë një mundësi për të gjithë anëtarët e Komitetit që të diskutojnë çështjet e rendit të ditës.
3. Në secilën mbledhje të rregullt, Komiteti do të shqyrtojë dhe diskutojë së paku gjendjen financiare dhe performancën afariste të IFJB-së, arritjen e targeteve, shtrirjen e IFJB-së, vendimet dhe ngjarjet e periudhës përkatëse.
4. Kryesuesi dhe anëtarët e Komitetit, do t'i shqyrtojnë me kujdes dokumentet e dorëzuara për Komitetin, para takimit, në mënyrë që të jenë në gjendje të kërkojnë sqarime ose informacione të tjera nga Menaxheri i IFJB-së.

5. Komiteti do të tentojë që të gjitha vendimet t'i merr në mënyrë unanime. Në rast të mospajtimit të mendimeve, vendimet e Komitetit do të merren me shumicën e thjeshtë të votave.
6. Në rast se ndonjëri nga anëtarët duhet të abstenojë nga votimi pasi ka shpalosur konflikt interesash, vota e tij nuk do të përfshihet në numërim. Në rast barazimi me vota, Kryesuesi i Komitetit duhet të ketë votën vendimtare.
7. Kryesuesi do të mbyllë takimin dhe do të t'i informojë anëtarë për datën e synuar të mbledhjes tjetër të Komitetit.

Neni 10

Mungesat nga mbledhjet e komiteteve

1. Anëtarët e komiteteve do të përpiqen të jenë të pranishëm në të gjitha mbledhjet e komiteteve, në rast mungesës arsyt e mungesës do të shënohen në procesverbalin e mbledhjes së Komitetit.
2. Nëse ndonjëri nga anëtarët e Komitetit mungon në tri (3) mbledhje të njëpasnjëshme, Kryeshefi Ekzekutiv duhet të njoftohet nga Kryesuesi i Komitetit apo Kryeshefi Ekzekutiv/Menaxheri i Përgjithshëm i IFJB-së dhe automatikisht do të iniciojë procedurën për shkarkimin e tij tek Bordi i Drejtorëve i PK Sh.A.

Neni 11

Procesverbali

1. Procesverbali i mbledhjes do të përfshijë kohën dhe vendin e mbledhjes, personat e pranishëm dhe agjendën e mbledhjes, çështjet e diskutuara, detajet e diskutimeve dhe arsyt e dhëna për çfarëdo vote negative ose abstenim, deklaratat e anëtarëve të Komitetit dhe të pranishmëve të tjerë, dokumentet e prezantuara dhe përfundimet (konkluzione, rekomandime ose vendimet e marra).
2. Procesverbali formal me shkrim do të nënshkruhet nga Kryesuesi që e ka kryesuar mbledhjen dhe nga personi i autorizuar për mbajtjen e procesverbalit pas aprovimit nga Komiteti.
3. Procesverbali i mbledhjes do t'iu dërgohet anëtarëve të Komitetit dhe personave të pranishëm në mbledhje në afatin prej 7 (shtatë) ditë pune pas mbledhjes së Komitetit.

Neni 12

Plotësimi/Ndryshimi

1. Bordi i Drejtorëve të Postës së Kosovës, me kërkesat ligjore që vijnë nga rregulloret e BQK-së apo ndryshimet ligjore, duhet ta plotësojë/ndryshojë këtë Rregullore pjesërisht apo tërësisht.

2. Bordi i Drejtorëve të Postës së Kosovës, me kërkesën e Kryeshefit Ekzekutiv të Postës së Kosovës, Kryeshefit Ekzekutiv/Menaxherit të Përgjithshëm të IFJB-së apo shumicës së anëtarëve të Komiteti të IFJB-së apo anëtarëve të komiteteve tjera, mund ta plotësojë dhe ndryshojë këtë Rregullore.
3. Procedura për aprovimin e ndryshimeve të Rregullores do të jetë e njëjta procedurë si për aprovimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 13 Shfuqizimi

Me këtë Rregullore shfuqizohet Rregullorja e Bordit të Postës së Kosovës nr. 01-2457/2017, e datës 20.09.2017.

Neni 14 Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi nga data e aprovimit nga ana e Bordit të Drejtorëve të PK-së.

Mentor Arifaj

Kryesues i Bordit të Përkohshëm
NPQ Posta e Kosovës Sh.A.

